



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT			
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE			
ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	20/OPK	Nr. Prot.	
Dep.		Br. Prot.	01-33/16
Dep.		Prot. No.	
Nr. I faq.		Data	
Broj stranica	02	Datum	08.01.2016
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4182/15, për znj. Lirija Bytyqi, Anëtare e Kuvendit Komunal në Prizren, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Lirija Bytyqi, Anëtare e Kuvendit Komunal në Prizren, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtarja e lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, znj. Bytyqi është takuar me zyrtarët e AKK – së, për tu njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Zyrtarja e lartë ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, znj. Bytyqi ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/4968/15), në të cilën vërtetohet se zyrtarja e lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat D.P.H “Vanessa”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Prefeni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

